



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:245313
Datë: 27.02.2023
Numri i dokumentit: 04019809

A.nr.1673/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Liridona Ajeti Kajtazi, me sekretare juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses, me numër kodit E-09/18, kundër të paditurës Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuara gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor jo publik, me datën 24.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, me numër kodit E-09/18, kundër të paditurës, Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuara gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës.
- II. ANULOHET** vendimi i Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, me Nr.749 i datës 05.08.2019 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor jopublik në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të përfaqësuesit të paditëses, e në mungesë të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata me qëllim të ruajtjes së sekretit zyrtar dhe si dhe mundësisë së zbulimit të rrethanave private të palëve, në kuptim të nenit 38.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka marrë aktvendim që seanca të mbahet me dyer të mbyllura –jo publike, duke i paralajmëruar palët në procedurë, për pasojat e zbulimit të informacioneve të mësuara në këtë çështje.

Paditësja me padi, ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës dhe që lënda të kthehet në rivendosje te organi administrativ.

E autorizuar e të paditurës, Avokatura Shtetërore, me përgjigjen në padi, ka kontestuar si të pabazuar kërkesëpadinë, duke kërkuar të refuzohet si e pa bazuar kërkesa-ankesa e këtu paditëses E-09//2018 dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.02.2023, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendim i dt.03.04.2019, vendim i dt.31.07.2019, kërkesa e dt.07.12.2022, procesverbali i takimit dt.30.05.2018, 31.07.2019, raport nga konsulta mjekësore, dt. 06.03.2018, 03.05.2018, 02.01.2018, 09.03.2018, 10.02.2018, 14.03.2018, kërkesë e dt.19.04.2019, 20.02.2019, vendim i dt.30.05.2018, kërkesë lidhur me rivendosjen e afatit për raste specifike, dt.27.03.2019, ankesë për rishqyrtimin e kërkesës dt.12.02.2019, shkresë e dt.25.07.1999, aplikacion i dt.20.03.2018,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës me nr.749 të datës 05.08.2019 e paditura në dispozitivin e të njëjtit, refuzon statusin Viktimë e Dhunës seksuale të luftës, aplikueses me nr. rasti/kodi E-09/18.

Paditësja e pakënaqur me këtë vendim, i është drejtuar kësaj gjykate me padi, duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Nga vendimi i kontestuar rrjedhë se ai përmban të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten ngase i njëjti vendim nuk përmban fare arsyetim, por vetëm dispozitiv, ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 për të pasur mundësi pala ti kuptoj arsyet e refuzimit të kërkesës së saj, dhe në këtë kuptim nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij.

Gjykata verën se në këtë çështje nuk kanë ekzistuar përjashtimet nga neni 49 të ligjit të sipërcituar për panevojshmërinë e arsytimit të vendimit, ku përcaktohet se “49.1. Arsyetimi i aktit të shkruar nuk është i nevojshëm kur: 1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj; 1.2. akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuese dhe nuk i cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose 1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës

zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesa juridike të ndonjë pale. 2. Në rastet e parashikuara në nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, akti mund të përbëhet edhe vetëm nga dispozitivi në formën e shënimit të shkruar mbi kërkesën përkatëse”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se vendimi i organit të paditur, i mungon arsyetimi ashtu siç është përcaktuar në nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ngase nga vendimi, përkatësisht arsyetimi i vendimit duhet ti siguroj palës mundësinë që ta kuptoj aktin administrativ, të këtë, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve dhe në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Ndërsa mungesa e një arsyetimi që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Mbi këto arsye, gjykata gjen se vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, të përcaktuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe mbi këtë bazë i njëjti vendim është dashtë të anulohet.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, dhe si rezultat i vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike është zbatuar gabimisht edhe ligji material.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit 5,6, 38, 43 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1673/2020, me datën 24.02.2023

**Sekretare Juridike
Nazife Sheholli**

**G j y q t a r j a
Liridona Ajeti Kajtazi**

***Këshillë Juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.*